



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:070766

Datë: 16.05.2023

Numri i dokumentit: 04284458

SCC-11-0003

Paditësi:

N H, nga Prizreni
të cilin e përfaqëson **Av S R**, nga Prizreni.

Kundër:

E Paditura:

K “P”, Prizren- L dhe B,
përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Manushe Karaqi dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dt. 11 maj 2023 dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur me 16 maj 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE

- 1. Padia e paditësit hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 mars 2009, paditësi kundër të paditurës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prizren, padi për vërtetimin e së drejtës së pronësisë të fituar me ndërtim në pronën e huaj, në pjesën e ngastrës nr. 8636, në vendin e quajtur “B”, në sipërfaqe prej 207 m². Në padi paditësi ka theksuar se paraardhësi i tij Sh H në vitin 1961, me kontratë më shkrim e ka blerë nga shitësi F N, ish nga f C, pjesën e patundshmërisë, mirëpo meqë kontratë nuk ishte vërtetuar në gjykatë, nuk kanë mundur të kryhen ndryshimet në kadastër. Sipas paditësit në vitin 1965 pjesa e pronës së

patundshmërisë ka hyrë në sistemin e fushës së Prizrenit- shfrytëzues K “P”, ku edhe sot evidentohet në emër të saj. Ka shtuar se në patundshmërinë në fjalë paditësi ka ndërtuar shtëpi familjare ku gjatë ndërtimit nuk ka ditur se është duke ndërtuar në tokën e huaj dhe se objekti i ndërtimit ka një vlerë rreth 250.000 €.

Me 15 prill 2009 e paditura ka paraqitur përgjigje në padi dhe e ka kundërshtuar padinë e paditësve si të pabazuar.

Me 28 dhjetor 2010 Gjykata Komunale në Malishevë me Aktvendimin C.nr.140/2006, është shpall jo kompetente në këtë çështje juridike dhe të gjitha shkresat e lëndës i ka dërguar në Dhomën e Posaçëm të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS).

Me 31 tetor 2022, gjyqtari DHPGJS ka kërkuara nga paditësi të dorëzoj aktvendimin e trashëgimisë.

Me 14 dhjetor 2022, paditësi ka dorëzuar Aktvendimin e trashëgimisë të dt. 24 nëntor 2022.

Me 13 mars 2023, përfaqësuesja e të paditurës ka parashtruar përgjigje në padi dhe e ka kundërshtuar padinë e paditësit, ku ndër të tjera ka theksuar se në rastet të tilla siç është tek paditësi ekziston vetëm një zgjidhje, që paditësi të paraqesë kërkesë tek komisioni për negociim të drejt për drejt pran AKP-së, për të cilën shpreson se ka elemente për aprovimin e saj.

Me 04 prill 2023, DHPGJS, me urdhër caktoj seancë dëgjimore në këtë çështje juridike për dt. 11 maj 2023. Palët janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Me 11 maj 2023, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i palës së paditur- AKP-së, ndërsa nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt. Gjykata priti përfaqësuesin e paditësit prej 13 minutave në sallën e gjyqimit por ai nuk u paraqit. Përfaqësuesi i të paditurës së parë AKP, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 11 maj 2023, në ora 13:30, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Gjykata ka pritur përfaqësuesin e paditësit av. S R në sallën e gjyqimit për 13 minuta, mirëpo ai nuk është paraqit në seancë. Përfaqësuesi i të paditurës – AKP, i propozoj gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata konstaton se përfaqësuesi i paditësit ishte i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar. Ftesën për seancë ai e kishte pranuar me 12 prill 2023, që i bie 28 ditë para seancës dëgjimore. Gjykata mbajti seancën dëgjimore dhe përfaqësuesi i paditësit nuk prezantoi në seancë. Në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që do arsyetonte mungesën e përfaqësuesit të paditësit, andaj duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës – AKP, që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykimi të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjyqimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Manushe Karaqi, Gjyqtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar